



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Vushtrri shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Përgjithshëm të Mjedisit
Institucioni	Komuna Vushtrri
Nr. i Referencës	RN00010500
Kodi	RPC0004171
Data e njoftimit	25.11.2022
Afati për aplikim	23.12.2022 - 06.01.2023

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Kryen inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike (rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave,
- shëtitorët, sipërfaqet e gjelbëruara dhe sipërfaqe tjera publike) nga dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet e paautorizuara;
- Bën verifikimin e dokumenteve burimore, të cilat shfrytëzuesit e hapësirës publike duhet t'i posedojnë, sipas ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale.
- Nxjerr vendime/urdhëresa lidhur me parregullsitë e paraqitura dhe ofron udhëzime juridike për palët;
- Ndërmerr masa ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale, harton kërkesat për fillim të procedurës kundërvajtësve dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave për të cilat është i autorizuar;
- Inspekton punimet e të gjithë operatorëve ekonomik/ndërmarrjeve, në sipërfaqet publike;
- Kryen mbikëqyrje inspektuese me qëllim mbrojtjen e sipërfaqeve publike, mbikëqyrë mirëmbajtjen e pastërtisë në
- sipërfaqet publike, nyjat sanitare publike, bartjen, deponimi dhe trajtimi i mbeturinave, përcjellja, trajtimi dhe pastrimi i
- ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, gjelbërimin, ndriçimi publik, tregjet, furnizimi me ujë-ujësjellësi, furnizimi i
- lagjeve me energji termike, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave;
- Kryen dhe detyra tjera të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nën ligjore;

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimitimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor).
- Kualifikime të posaçme formale: Inxhinieri Mjedisi/ Mjedis/ Kimi e Përgjithshme, Ekologji dhe të ngjashme
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0000923	RN00007066	Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit	Profesional 1	7	Komuna Vushtrri	Inspektimi I Çështjeve Publike / Profesional

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Certifikata nga gjykata

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuritë nga fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- Njohuritë nga fusha e inspektimeve;
- Njohuri nga legjislacioni për fushën përkatëse:
- Aftësi dhe pavarësia në vendim marrje;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim dhe bashkëpunim.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Udhëzim për aplikim;

Bashkangjitur keni linkun në youtube për mënyrën e aplikimit përmes sistemit - platformës <https://konkursi.rks-gov.net/>.

<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI>

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

